



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME SH.A. MEMALIAJ

---

Data 10.10.2022

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE  
TEKNIKE DHEKRITEREVE PËR KUALIFIKIM**  
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim vendosje elektropompë dhe panel elektrik për stacionin e pompimit Bambull, Qyteti Memaliaj”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42122130-0 - Pompa uji, 44175000-7 – Panele**

**Referenca e procedures: REF- 46664-10-19-2022**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4.166.667 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2020, 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.2** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 2 (dy) vitet e fundit financiare përkatësisht (2020, 2021) në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht 1 666 666.8 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e

*gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë tetë) lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 2(dy) vitet e fundit financiare është jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 833 333.4 (tetëqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre pikë katër) lekë pa tvsh.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

2.4 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese çertifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që ka lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 (ose e përditësuar)** në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit;
- **ISO 14001:2015, (ose e përditësuar)** lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.*

**Argumentimi:** Kriteret për paraqitjen e ISO-ve sa më sipërcituar u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Çertifikata duhet të jenë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për te realizuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.

*Kerkesa per certifikime sipas standardeve ISO jane ne vetvete nje garanci me teper per suksesin e projektit, ne lidhje me cilesine e produktit.*

**Argumentimi:** Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga Operatori Ekonomik, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit, planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit/shërbimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 14001 specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimit të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;

- *Respektimin e ligjeve;*
- *Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;*
- *Përmirësimin e imazhit të kompanisë;*
- *Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.*

2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesi autorizim nga prodhuesi apo distributor i autorizuar për mallrat e kërkuar. Fabrika e prodhimit të jetë në një nga vendet e BE ose SHBA. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributor i autorizuar nga prodhuesi OE duhet të paraqes dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

2.6 Deklaratë e OE e konformitetit për pompën dhe motorin elektrik zhytës, shoqëruar me certifikatën e kalibrimit të instrumentit të laboratorit të testimit të prodhimit ( mates rrjedhës, manometra, vakum metra Watt-metro, etj ). Nga një kalibrim I fundit nga instrumentat anëtare të “Europeanco – operation for Accerediton” (EA) ose ekuivalent.

2.7 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektrik katalogun dhe datasheet të prodhuesit të mallrave objekt prokurimi ku të pasqyrohen që rendimenti I efijencës së elektropompës në përqindje. Në rats se katalogët ose broshurat janë në gjuhën të huaj duhet te paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe sispas legjislacionit në fuqi.

**Argumentimi:** *Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

2.8 Deklaratë e ofertuesit që merr përsipër transportin dhe/ose montimin (nëse do te kërkohet nga AK)

**Argumentimi:** *Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga personi pergjegjes ,specilist i fushes, me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285,datë 19.05.2021, “Për*

*miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”.*

*Detyrë kryesore funksionale e këtij institucioni është “Furnizim vendosje elektropompë dhe panel elektrik për stacionin e pompimit Bambull, Qyteti Memaliaj”*

Qellimi i furnizimit dhe instalimit të elektropompe së Stacionit të Bambullit është rritja e eficiencës së energjisë në këtë stacion. Zëvendësimi i pompës ekzistuese me pompë të re centrifugale me aks horizontal me këto parametra si më poshtë.

## **1. F.V Elektropompe centrifugale horizontale 200 kW**

### **Pompa**

- Prurja	l/s	jo me pak se 70
- Hashi (H)	m	jo me pak se 110
- Diametri i helikes	mm	300
- Tipi i instalimit		Elektromotor + pompe + shasi e integruar ne nje trup
- Fuqia maksimale ne aks		200 kW
- Fuqia nominale ne aks	kW	jo më pak se 180
- NPSH	m	jo më pak se 6
- Presioni i dërgim	PN	PN16
- Presioni i shkarkimit	PN	PN16
- Numri i shkalleve min		2
- Shpejtesia e rrotullimit	1/min	1450

### **Materialet**

- Trupi i pompes	Gize
- Helika	Gize
- Aksi	celik i kromuar

### **Motori**

- Fuqia nominale	kW	200
- Numri i poleve		4
- Shpejtesia	1/min	1500
- Klasa e mbrojtjes	IP	55
- Klasa e izolacionit		F
- Numri i fazave		3

- Tensioni elektrik V 400
- Rryma nominale A 360

## 2. F.V me Softstarter 200 kW

Softsarteri duhet të jetë i kompletuar me komponentet si më poshtë:

- Softstarter 200kW 400A (leshues i bute)
- Rele monitorimi per tensionin dhe nivelin e ujit ne pus
- Rele mungese faze
- Automat kryesor
- Llama sinjali
- Butona
- Akeseore te ndryshem, kablllo, fije, kapikorda, kanalina, emertime etj

Parametrat kryesor të sofstarterit:

- Softstarteri duhet të jetë i ndertuar për punim në tension deri në 600VAC dhe me tension kontrolli 360VAC 50/60Hz.
- Tensioni nominal i punes 200...600 VAC
- Tensioni i qarqeve te kontrollit 100...360VAC ose 24VDC
- Frekuenca nominale 50Hz
- Fuqia nominale e punes me tokezim te mbrojtur 200kW(400V)
- Rryma nominale e punes me tokezim te mbrojtur 250A
- Mbrojtja nga mni ngarkesa Po, e inkorporuar
- Diapazoni i rregullimit te rrymes nominale 30...100%
- Rryma maksimale e leshimit 4 fishi i rrymes nominale per 10 sek
- Tensioni fillestar ne leshim 10...99%
- Tensioni ne zbritje 100...10%
- Funksioni i limitimit te rrymes 1.5...7.5 fishi i rrymes nominale
- Celes per kthim ne lidhje yll te brendeshme Po
- Rele sinjalizuese per operimin Po
- Rele sinjalizuese per bypass Po
- Rele sinjalizuese per difekt Po
- Rele sinjalizuese per mbingarkesen Po
- Daljet analoge 0...10 V, 0...20 mA, 4...20 mA
- Indikator per start/gati per pune ON (LED) Po, Jeshile
- Indikator gjate kohes se punimit ne ngarkese R (LED)Jeshile
- Indikator sinjali per mbrojtjen (LED) E kuqe
- Komunikimi Modbus i inkorporuar, Anybus, FieldBus
- Temperatura e punes -25...+60 °C

Paneli duhet të furnizohet i kompletuar dhe i testuar nga reparti i projektimit dhe montimit.



### **3. F.V KUNDERVALVUL fi 200 mm PN16**

Kërkesat janë në përputhje me nenin 36 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 10.10.2022, ora 12:00.

*Njësia e Prokurimit*